



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr.81

Prishtinë, më 25.06.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Bekë Berisha, kryetar i Komisionit Enver Dugolli- nënkryetar i parë, Erxhan Galushi - nënkryetar i dytë, Shqipe Mehmeti Selimi, Mefail Bajqinovci, Arbër Rexhaj, Dimal Basha, Rashit Qalaj, Hisen Berisha, Anton Quni anëtar.

Mungoi: Hisen Berisha, -anëtar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Faton Krasniqi- ndërlidhës legjislativ mes Kuvendit dhe Ministrisë së Mbrojtjes, Besnik Fetahu (Grupi parlamentar i VV), Laurenta Zogaj-Asistente në Komisionin Parlamentar

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku (koordinator), Zarë Aliu (zyrtare e lartë)

Mbledhjen e kryesoi Bekë Berisha, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Komisionit të mbajtur me datë 10.05.2024; 13.05.2024 dhe 28.05.2024;
3. Shqyrtimi i projekt-rezolutës lidhur me Raportin e Punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi, për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës;
5. Të ndryshme.

Në vijim të mbledhjes u kalua në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e Komisionit të mbajtur me datë 10.05.2024; 13.05.2024 dhe 28.05.2024.

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projekt-rezolutës lidhur me Raportin e Punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi, për vitin 2022.

Kryetari, të nderuar anëtar të Komisionit, sipas procedurave e kemi në shqyrtim projekt-rezolutën për Raportin e Punës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi, për vitin 2022. Sipas ligjit për funksionimin e Agjencive të Pavarura Komisioni/Kuvendi miraton Raportin vjetor të punës për projekt-rezolutës. Si komision e kemi shqyrtuar këtë Raport, por për procedimin është pritur edhe rekomandimet e Komisionit për buxhet dhe Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike, dhe tanimë janë plotësuar kushtet për votimin e Projektrezolutës. Tekstin e rezolutës besoj e keni parë dhe nëse jeni dakord votojmë për miratimin dhe dërgimin e saj në seancë plenare?

4. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës.

Kryetari, lidhur me këtë pike ju njoftoi se si Komision funksional për këtë Projektligj, kemi pranuar Raportet me rekomandime nga Komisionet e përhershme dhe kështu janë plotësuar kushtet për procedim në lexim të dytë, andaj propozoi miratimin e këtij raporti dhe procedimin për në seancë plenare. A jeni për?

Rashit Qalaj, lidhur me raportin për këtë Projektligj dhe amendamentet e propozuara, disa nga amendamentet që janë propozuar nga ana e tij tashmë kanë hyrë si amendamente të Komisionit, që është në rregull. Ndërsa amendamentet e propozuar nga ana e tij janë të renditura që janë pa përkrahjen e Komisionit, ndërsa amendamentet që e kanë trajtuar po të njëjtën çështje, janë të renditura si amendamente në raport.

Enver Dugolli, theksoi për procedurë, në momentin që amendamentet shkojnë si të Komisionit, ndërsa amendamentet e propozuar njëfarë mënyrë nuk kanë nevojë të jenë.

Rashit Qalaj, propozoi që të hiqen amendamentet që janë në emër të tij, pasi shkojnë në emër të Komisionit.

Anton Quni, theksoi se komentet e tij nuk kanë të bëjnë me Projektligjin, por kushte e punës në Këshillin e Sigurisë. Kush ka pasur mundësi të bëjë vizita, mund të konstatoj që personeli i Këshillit të Sigurisë, punojnë në një ambient me kushte të limituara. Nuk e di pse është menduar që ky personel të punoj në një ambient i cili është i planifikua për situata e jashtëzakonshëm, pasi detyrat e rëndomta që i kryejnë, i kryejnë si me qenë në situata të jashtëzakonshme dhe nuk është i përshtatshëm për punë e përhershme. Pavarësisht që kjo çështje nuk trajtohet në Projektligj, si anëtar të Komisionit duhet të ngrisim këtë çështje tek autoritet e Qeverisë, që personelit të kësaj organizata ti sigurohen kushtet e punës.

Kryetari, theksoi se e përkrah propozimin e z.Quni, lidhur me kushtet e punës në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, në mënyrë që të kenë kushtet e punës si në kushte normale ashtu edhe në situata të jashtëzakonshme.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOMANDIM

Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin Nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Kosovës dhe procedohet për lexim të dytë në seancën plenare

5. Të ndryshme.

Kryetari, të nderuar anëtar të Komisionit, a keni diçka për të shtuar në këtë pikë?

Anton Quni, tha se ka një çështje për të ngritur, por propozoi që takimi të jet i mbyllur për media.

Kryetari, a jeni për që takimi në vazhdim të mbahet me dyer të mbyllura?

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes me vota unanime vendosi që takimi në vazhdim të jetë me dyer të mbyllura dhe diskutimi në këtë pjesë nuk pasqyrohet në procesverbal.

Mbledhja përfundoi në orën 10:46

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Bekë Berisha,
Kryetar i Komisionit
